AKTI I THEMELIMIT

TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELEKROINVEST"

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Viti njemije e nenteqind e nentedhjete e pesë

më     Qershor ne Tirane

PULLE TAKSE 10 RESHQIPERISE

NOTER TIRANE

Jane themelues ortaket:

1) Petrit Peqini, i biri i Xhelalit, i dt. 28.11.1950, banues ne Rrugen "M.Shyri" P.1,Shk.13,Ap.198

2) Jani Teta, i biri i Sokratit, i dt.13.10.1952, banues ne rrugen "Niko Avrami" P.17,Shk.5, Ap.58

Brenda identiteteve te paleve te siperme, pasi u ra dakord per te gjitha ceshtjet, u vendos te perpilohet ky akt themelimi si marreveshje per themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar mbeshtetur ne principet e meposhteme:

I PARI

Themeluesit do te ndertojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta emertojne "ELEKTROINVEST" sh.p.k.

I DYTI

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne ~~Rr. M. Shyri P. 1 Shk13/198.~~ N. Avrami P. 17, Shk5 Ap 50.

I TRETI

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe prej mbi 10 vjet.

I KATERTI

Objekti i shoqerise do te formulohet me akt te vecante dhe pasqyrohet gjeresisht ne statutin e kesaj shoqerie qe i bashkangjitet ketij akti themelues.

I PESTI

Kapitali social do te jete 100.000 leke i investuar nga ortaket e kesaj shoqerie sipas kuotave te meposhteme:

1)Petrit Peqini     50%

2)Jani Teta     50%

I GJASHTI

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti themelues edhe me forma

e percaktuara ne statut, i cili do te nenshkruhet nga ortа
do te miratohet nga ana e Gjykates se rrethit te Tirane.

ORTAKET

1) Petrit Peqini

2)Jani Teta

STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELEKROINVEST"

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

Neni 1

1)Petrit Peqini, i biri i Xhelalit, lindur me 28.11.1950 ne Tirane banues ne Rrugen "M.Shyri", P.1, Shk.13, Ap.198

2)Jani Teta, i biri i Sokratit, lindur me 13.10.1952, banues ne Tirane ne rrugen"Niko Avrami", P.17, Shk.5, Ap.58.

Personat e mesiperm duke patur zotesi per te vepruar kontaktuan per sa me poshte vijon duke hartuar statutin e shoqerise me pergjegjes te kufizuar "ELEKROINVEST" sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik e krijuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe si i tille e fillon aktivitetin me rregjistrimin e saj ne Regjistrin Tregetar, ne organet perkatese tatimore.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Tirane ne adresen: Rr. N. Avrami, P.17, Shk.5, Ap.50 ~~M. Shyri, P.1, Shk.13, Ap.198.~~

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me zgjerimin e aktivitetit me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacioni shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (akti i themelimit,statuti), ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te.

LIBRI I SHOQERISE

Neni 6

Per te saktesuar veprimtarine e vet ekonomike dhe maredheniet e punes shoqeria do te çele librin e vet i cili do te quhet Libri i Shoqerise.

Teta

FUSHA E AUTORITETIT TE PALEVE

Neni 7

Fusha e autoritetit te paleve dhe perqindja e fitimeve ose humbjeve do te kene si kriter baze perqindjen e kapitalit qe disponojne ne shoqeri, si dhe me kompetencat e Asamblese e te organit ekzekutiv te cilta do te pershkruhen ne kete statut.

KONFIDENCIALITETI

Neni 8

Secili nga ortaket vete,dhe per personat e pranuar ne shoqeri,bien dakord qe te mos ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria,kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet dhe qellimet qe ajo ka per te ardhmen.

Neni 9

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet,si letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet, e ndryshme duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas saj fjalet SHPK, kapitalin themelor dhe emrin e administratorit.

OBJEKTI

Neni 10

Shoqeria ka si objekt te saj te veprimtarise si me poshte: Import-Eksport,tregeti me shumice e pakice te artukujve industriale e ushqimore,bujqesor,blegtoral,te makinerive dhe paisjeve,paisje elektronike dhe elektroshtepiake,medikamente,artikuj elektrike, hidraulike, hidrosanitare, materiale e lende ndertimi,pjese kembimi, karburante e lubrifikante,bime medicinale,mobilieri,artikuj kozmetike, duhan e cigare,bar restorant,servis automjetesh,komisioneri,konsulence teknike,kryerjen e aktiviteteve prodhuese bazuar ne lendet e para te vendit dhe te importit,ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore dhe kompletimi dhe instalimet e nevojshme per to,instalimi i impianteve dhe makinerive ngritese transportuese,mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal,ndertim impiante elektrike, telefonike radiotelevizioni dhe mirembajtja e tyre,ndertim impiante ashensoresh, shkalle te ndryshme,transportiere dhe mirembajtja e tyre,ndertim montim,impiante pneumatike, te sigurimit te kontrollit "KIP" e mirembajtja e tyre, ndertim montim impiante per prodhimin e energjise nga burime te ndryshme,impiante elektrike per centralet dhe prodhim te transformatoreve,linja te T.N,dhe T.U, linja ndricimi dhe aparatura elektrike dhe mirembajtja e tyre,instalimi i mpianteve dhe makinerive ngritese e transportuese(vinça,teleferike e te tjera te kesaj natyre)/

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 11

Shoqeria do ta zhvilloje aktivitetin e saj per nje kohe mbi 10 vjet te mara si vit kalendarik,duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar, me perjashtim te rasteve kur shkrihet para kohe o oso te zgjatjes se afatit te saj, sipas rregullave te percaktura me poshte.

KAPITALI THEMELOR

Neni 12

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 leke.
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket.
Shoqeria mund ta shtoje ose ta pakesoje kapitalin e saj me miratimin e Asamblese se Ortakeve.
Ne rast zmadhimi te kapitalit themelor, nepermjet shtimit te pjeseve te reja,ortaket kane te drejten e perparesise ne nenshkrim,proporcionalisht me shumen e kapitalit te derdhur ne kapitalin themelor.
Zvogelimi i kapitalit i prek te gjithe ortaket ne te njejten mase sipas kontributeve te derdhur ne kapitalin themelor.
Kontributi i secilit ortak eshte i ndare ne menyre te barabarte proporcionalisht nga 50% secili.

LENIA DHE TRANSFERIMI I KAPITALEVE

Neni 13

Pjeset e kapitalit themelor jane lirishte te transferueshme ndermjet ortakeve, te cileve u jepet e drejta e preferences ne kete transferim ne proporcion me kuoten qe disponojne. Ato mund ti transferohen edhe te treteve vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve dhe jo me kushte me te favorshme se ato me te cilat i jane ofruar me pare ortakut tjeter.
Gjithashtu ato jane lirishte te transferueshme ne rast te ndonje ndarjeje mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie. Transferimi behet me anen e aktit noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 14

Shoqeria do te konsideroje qendren e vet ne Tirane, ne Rrugen"Niko Avrami",P.17,Shk.5,Ap.58. si shoqeri NENE e cila rast pas rasti do te hapet me ane filialesh ose shoqerishe te perbashketa ne te gjitha ato vende ko do te shohe interes per permbushjen e qellimit te saj.

Neni 15

Organi me i larte i drejtimit eshte Asamblea e Ortakeve. Asamblea mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asamblea qofte e zakonshme ose e jashtezakonshme do te thirret ne te gjitha rastet qe organi administrativ e gjen te nevojshme.

Neni 16

Shoqeria mund te administrohet nga;

-nje administrator i vetem,dhe mungese te tij nga person i autorizuar

-nje keshill administrativ

-dy administratore te nje firme te vetme ose te vecanta per secilin.

Neni 17

Administratori ose administratoret n.q.s' do te kete, mund te jene ose jo ortake sipas percaktimit te Asamblese.

Administratori shkarkohet me vendim te Asamblese ose kur jep vete doreheqjen.

Neni 18

LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël ose librave të tjerë edhe këto libra:

- Librin e ortakëve në të cilin shënohet emri i plotë i sejcilit ortak dhe kuota në kapitalin themeltar;
- Librin e mbledhjeve dhe i vendimevz të Asamblesë së Ortakëve;
- Librin e organit administrativ.

BILANCI

Neni 19

Bilanci mbyllet më 3I dhjetor të çdo viti , ku i pari përjashtimisht do të jetë më 3I dhjetor 1995.

Llogaritë vjetore, iventari, repoztet mbi operacionet e vitit financiar dhe ato të ekspertit kontabël do të miratohen nga Asambleja e Ortakëve.Miratimi i tyre bëhet brenda një afati prej 4 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

DIVIDENTËT

Neni 20

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit, të cilat ndahen sipas kontributeve në kapitalin themeltar, pra në mënyrë të barabartë, Asambleja e Ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentëve mbi fitimin.

./..

Fitimi që do të ndahet në propocion me pjesët e kapitalit, përbe. fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mën, anë për fondin rezervë të domosdoshëm të përcaktuar nga ortakët, të fondeve të tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

MARRËDHËNIET PËR PUNËSIM

Neni 21

Kriteret e përgjithëshme të punësimit të personave të tjerë, numrin e tyre, kufijtë e pagesës dhe detyrat e sejcilit në shoqëri, caktohen nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 22

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, midis saj dhe të tretëve, do të tentohen të zgjidhen me mirëkuptim në rast të kundërtë ato do ti drejtohen për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 23

~~Paxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx~~
Shiqpria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar në statut, me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit me miratim të Asambles së Ortakëve ose kur ka një prishje të parakohëshme për arsyet e parashikuara në ligjë.

Neni 24

Shoqëria hyn në proçesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. për kryerjen e këtij proçesi Asambleja e Ortakëve, cakton një ose disa likujdues të cilët i paraqesin asaj raportet mbi gjendjen e aktivit dhe të pasâvit, mbi ndjekje e operacioneve të likujdimit, mbi afatin e duhur të përfundimit të tyre.
Në fund të proçesit të likujdimit Asambleja e Ortakëve vendos mbi bilancin përfundimtar dhe mbi mbylljen e proçesit të likujdimit.Mbas pagimit të kreditorëve dhe të shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar, tek kontribuesit përkatës, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve propocionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar.

Neni 25

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, i referohen plotësimeve nga ana e ortakëve me anë amendamentesh. Ndryshimet dhe plotësimet nuk prekin personalitetin juridik të shoqërisë. Ato bëhen me të njëjtën

./..

..oçedurë me të cilën bëhet dhe vetë nxjerrja e këtij statuti.
Statuti hartohet në 4 kopje me fuqi të barabrtë sejcila, dhe pasi lexohet dhe gjendet në rregull, nënshkruhet nga ortakët.

O R T A K Ë T

/Petrit Peqini / Jani Teta /

Tiranë, më 6/06/1995.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANË
Nr. 6794 Rep.
Nr. 2208 Kol.

V E R T E T I M

Sot me daten 7.6.1995 para meje noterit te dhomes noteriale te Tiranes, u paraqiten personalisht Petrit Peqini dhe Jani Teta, per identitetin e te cileve u sigurova nepermjet leternjoftimeve te tyre personale, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet deklaruan se sa me siper eshte nje akt i redaktuar prej tyre nenshkruan rregullisht dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI

DHOMA NOTEREVE TIRANE
NOTER PUBLIK
ANDON PANO